



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS  
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION  
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

Federata e Basketbollit  
të Kosovës  
+383 49 738 080  
federata@basketbolli.com

Lagjia "Arbëria"  
Blloku C3, Nr. 83  
Str: Radovan Zogovic  
10 000 Prishtina

# RREGULLORE E PUNËS E KOMISIONIT TË GARAVE TË FEDERATËS SË BASKETBOLLIT TË KOSOVËS

Prishtinë, 2023

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





Mbështetur në nenin 23, alineja 1.9. të Statutit të Federatës së Basketbollit të Kosovës, Bordi i FBK-së më 30.08.2023, miraton këtë:

## RREGULLORE TË PUNËS E KOMISIONIT TË GARAVE

### Neni 1 - Qëllimi i rregullores

Me këtë dokument synohet të rregullohet puna e Komisionit të Garave të FBK-së, përbërja, detyrat, të drejtat, përgjegjësitë dhe mënyra e raportimit të këtij komisioni si dhe raportet e komisionit të garave me instancat tjera në FBK.

### Neni 2 - Përbërja

Komisioni i Garave themelohet nga Bordi i FBK-së dhe përbëhet nga tre anëtarë (Kryesuesi dhe dy anëtarë të tjerë), të cilët emërohen para fillimit të çdo edicioni (preferohet që të paktën dy prej tyre të jenë ish gjyqtarë ose vëzhgues).

### Neni 3 - Mbledhjet

1. Komisioni i Garave mban mbledhje të rregullta pas përfundimi të secilës xhiro të garave të seniorëve, më së largu dy (2) ditë pas përfundimit të xhiros së rregullt.
2. Komisioni i Garave mund të mbajë edhe mbledhje të tjera, përkatësisht:
  - 2.1. para fillimit të edicionit (kur trajtohen Propozicionet dhe Rregulloret),
  - 2.2. gjatë edicionit (nëse ka kërkesa nga klubet ose Bordi i FBK-së); dhe

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





**2.3.** para e gjatë playoff-it të ligave të seniorëve, kur kërkohet vendimmarrje në afat më të shkurtër.

**3.** Ftesën për mbledhje e dërgon Kryesuesi i Komisionit të Garave dhe mbledhjet mbahen në zyrat e FBK-së. Në rast se pjesëmarrja fizike është e pamundur për ndonjëri nga anëtarët, për shkaqe objektive, lejohet pjesëmarrja dhe votimi elektronik, por duhet të ceket si i tillë në procesverbal.

**4.** Procesverbalet e mbledhjeve dhe të vendimeve nga Komisioni i Garave, mbahen me rregull nga shërbimi administrativ i FBK-së dhe arkivohen në FBK. Anëtarëve e Komisionit të Garave për pjesëmarrje në mbledhje iu takon mëditje në lartësi që vendoset nga Bordi i FBK-së.

## Neni 4 - Detyrat dhe përgjegjësitë

### **1. Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore të Komisionit të Garave, ndër të tjera përfshijnë:**

- 1.1.** Administrimi, regjistrimi dhe menaxhimi i të gjitha ndeshjeve/garave të seniorëve në kuadër të FBK-së;
- 1.2.** Përgatitja e Propozicioneve të Garave të FBK-së dhe Kupës së Kosovës të të dyja konkurrencave;
- 1.3.** Propozimi i kalendarëve të garave të të dyja konkurrencave;
- 1.4.** Përgatitja e informatorëve të të gjitha ligave seniorë në të dyja konkurrencat, si dhe publikimi i tyre në faqen zyrtare të FBK-së (në bashkëpunim me shërbimin administrativ);
- 1.5.** Zbatimin e Propozicioneve të Garave dhe akteve tjera normative të nevojshme për administrimin e garave;

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





- 1.6. Rishikimi rregullisht i akteve të tjera normative të FBK-së që ndërlidhen me garat dhe përditësimi i tyre në bazë të nevojave për Bordin e FBK-së;
- 1.7. Koordinimi i ngjarjeve të veçanta të FBK-së, si play-offi, Kupa e Kosovës, Superkupa e Kosovës etj;
- 1.8. Komunikimi me të gjitha klubet anëtare të FBK-së.

## **2. Për realizimin e detyrave dhe përgjegjësi, Komisioni i Garave shërbehet me këto dokumente:**

- 2.1. Propozicionet e Garave të ligave të seniorëve FBK-së;
- 2.2. Rregulloren për Regjistrim dhe Kalim në FBK;
- 2.3. Rregulloren dhe Kriteret për Licencim;
- 2.4. Rregulloren Disiplinore;
- 2.5. Aktet tjera normative, sipas nevojës.

## **3. Për realizimin e detyrave dhe përgjegjësi, Komisioni i Garave bashkëpunon rregullisht me:**

- 3.1. **Komesarin e Garave** - përgjegjës për delegim dhe vlerësim të gjyqtarëve dhe interpretim të rregullave të lojës si FIBA instruktur nacional;
- 3.2. **Shërbimin administrativ** - një përfaqësues në çdo mbledhje të Komisionit dhe përkujdeset për publikim dhe arkivim të vendimeve;
- 3.3. **Gjyqtarët dhe vëzhguesit** - kur ka nevojë për informata ose raporte shtesë, sipas dispozitave të dokumenteve në Nenin 4.
- 3.4. **Bordin e FBK-së** - përgjegjës për themelimin dhe emërimin e Komisionit të Garave, instanca ku Komisioni raporton në përfundim të edicionit garues dhe instanca të cilës Komisioni i rekomandon ndryshime dhe freskimet në sistem dhe menaxhim të garave;

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:

Automotive Sponsor:

Youth Basketball supporters:



- 3.5. Sekretarin e Përgjithshëm të FBK-së** - përgjegjës për ligjshmërinë e punës në Federatë;
- 3.6. Përgjegjësit për regjistrim, kalim dhe për përfaqësuese në FBK** - rregullojnë të drejtat e paraqitjes së lojtarëve;
- 3.7. Anëtarët e tjerë të zyrës ekzekutive të FBK-së**, sipas nevojës.

## Neni 5 - Vendimet e Komisionit të Garave

**1.** Komisioni i Garave është organ themelor për administrim të garave të seniorëve dhe vendimet e këtij komisioni cilësohen si vendime të shkallës së parë. Klubet, lojtarët ose palët tjera të prekura nga vendimet e Komisionit të Garave, sipas akteve normative të FBK-së, kanë të drejtë ankese në Komisionin Arbitrar (që shërben si shkallë e dytë).

**2.** Komisioni i Garave bën regjistrimin e ndeshjeve, shqiptimin e dënimeve për shkeljet eventuale në ndeshje dhe merr vendime tjera që kanë të bëjnë me garat, në shkallë të parë.

**2.1.** Komisioni i Garave bën regjistrimin e ndeshjeve, shqiptimin e dënimeve përmes informatorëve.

**(a)** Pjesa e parë e informatorit përmban regjistrimin e ndeshjeve - rezultatet dhe komentet e përgjithshme në bazë të raportit të vëzhguesit;

**(b)** Pjesa e dytë liston dënimet e shqiptuara - dënimet shqiptohen në mënyrë automatike (pra nuk është çështje votimi) dhe Komisioni i Garave mund të shqiptojë dënime për akterët e ndeshjeve edhe pse ata nuk janë shënuar dhe nuk janë sanksionuar nga ana e vëzhguesit dhe gjyqtarët, por është konstatuar nga video xhirimet e ndeshjes apo prezencës së tyre në ndeshje;

**2.2.** Sipas nevojës, Komisioni i Garave merr edhe vendime tjera që kanë të bëjnë me garat, vendime të cilat merren me shumicë votash.

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:

Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





**2.3.** Komisioni i Garave shqipton dënimet dhe merr vendime për të gjitha ndodhitë si shkallë e parë, pra nuk mund të referojë lëndë tek organet e tjera të FBK-së për të marrë vendim apo të iniciojë procedurë disiplinore përderisa ka kompetencë të shqiptojë dënim apo të merr vendim.

**3.** Të gjitha ndeshjet për të cilat ekzistojnë ankesat apo rastet tjera të cilat nuk lejojnë regjistrimin e ndeshjes, Komisioni i Garave është i obliguar që t' i regjistrojë në afatin sa më të shkurtër, më së voni 7 ditë pas përfundimit të xhiros apo të ndeshjes. Gjatë kësaj periudhe, Komisioni mund të kërkojë rekomandim edhe nga Bordi i FBK-së ose nga Kryetari dhe Sekretari i Përgjithshëm i FBK-së.

**4.** Në rast kur është paraqitur ankesa apo ekzistojnë raste të tjera për të cilat ndeshja nuk mund të jetë e regjistruar, afati i regjistrimit shtyhet (pezullohet) deri në ditën e marrjes së vendimit, gjegjësisht deri në marrjen e vendimit për zgjedhjen e rastit për të cilin ndeshja nuk është regjistruar.

**5. Të gjitha ndeshjet për të cilat nuk ka ankesa apo raste të tjera të cilat nuk lejojnë regjistrimin e ndeshjes, Komisioni i Garave është i obliguar që t' i regjistrojë 48 orë pas përfundimit të ndeshjeve.**

**6.** Njëherë ndeshja e regjistruar apo vendimi i marrë nuk mund të anulohet nga ana e organit të njëjtë.

**7.** Komisioni i Garave, në bazë të akteve normative nga neni 4.2 vendos për të drejtën e paraqitjes së klubeve dhe lojtarëve në liga të seniorëve dhe vendos në shkallë të parë për shkeljet eventuale të këtyre rregullave.

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:

Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS  
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION  
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

Federata e Basketbollit  
të Kosovës  
+383 49 738 080  
federata@basketbolli.com

Lagjia "Arbëria"  
Blloku C3, Nr. 83  
Str: Radovan Zogovic  
10 000 Prishtina

## Neni 6 - Dispozitat përfundimtare

Kjo rregullore hyn në fuqi në ditën e miratimit nga Bordi i FBK-së. Për situata që nuk parashihen në këtë Rregullore, vlejné dispozitat e dokumenteve të cekura në nenin 4.2 dhe aktet tjera normative të FBK-së.

Në emër të Bordit të FBK-së,

Kryetar  
Arben **FETAHU**



Federata e Basketbollit të Kosovës  
Prishtinë 30.08.2023

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:

